



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

DREJTORATI PËR INFRASTRUKTURË

Data:	16.05.2026
Për:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës
Kopje:	z.Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës
Nga:	z.Sead Aliu – Drejtor për Infrastrukturë
Lënda:	Raport për muajin 01.05.2026-31.05.2026

Në bazë të përgjegjësiave dhe kompetencave të Drejtoratit për Infrastrukturësë gjatë periudhës prej datës 31.04.2026 deri 30.04.2026, DI ka kryer aktivitetet që ka pasur të planifikuara dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara.

Drejtorati për Infrastrukturë gjatë kësaj jave ka pranuar dhe zgjidhur këto kërkesa:

Pasqyra e lëndëve (kërkesave)				
Nr. i kërkesave të pranuar	Të zgjidhura	Të refuzuara	Në kompetencë	Në procedurë
21	10	3	3	5

Aktivitetet gjatë muajit Majë

- **Asfaltimi i rrugicave në fshatrat Llugaxhi dhe Dobraj e Madhe**

Kanë vazhduar punimet për rregullimin e rrugicave në Fshatin Dobraj e Madhe, pozicione të cilat është punuar janë: Gërmimi dhe mbushja me material guror i rrugicave në fshatin e lartë cekur, jan kryer rreth 90% e rrugicave me gërmim dhe mbushje, afer perfunimit.

- **Asfaltimi i rrugicave në fshatrat Bujari, Vershevc, Leletiq, Magure.**

Kontrata është dy vjeçare 2025/2026, kanë vazhduar punimet sipas kontratës, konkretisht është punuar në fshatin Magure dhe Leletiq, ku në fshatin Magure janë përfunduar punimet në pozicionet e gërmimit dhe mbushjes, ndërsa ne Leletiq kemi filluar me punimet në rrugicat e fshatit.

- **Asfaltimi i rrugicave në Fshatrat: Gadime, Sllovi, Smallush**

OE nuk ka vazhduar me punime për realizim të kësaj kontrate, për arsye së ngritjes së çmimit të derivateve!!

- **Asfaltimi i rrugicave në Fshatrat: Babush, Gadime e Epërme-Kanë** përfunduar punimet në fshatin Babush në pozicionet e gërmimit dhe mbushjes me material guror.

- **Ndërtimi I Urës rruga Marie Shllaku**

OE vazhdon me intensitet tejet të ulët.

- **Ndërtimi i Qendra Multi funksionale (Shpija Kulturës)**

Vazhdojnë punimet sipas kontratës së nënshkruar, ku tani jemi duke e përgatitur pllakën mbi përdhes (armimi dhe betonimi)

- **“Ndërtimi i trotuarve në fshatin Baicë”, me numër identifikues**

Kanë vazhduar punimet duke përfshirë pozicione të ndryshme të kontratës, Gërmim, Mbushje, Furnizimi dhe montimi i skajorëve.

- **“Ndërtimi i nënkalimit, vazhdimi i ndërtimit të sheshit, ndërtimi i parkut qendror të qytetit dhe parkingut nentokesor në Lipjan” kontrata me nr. 613-23-6745-5-1-1.**

Janë zhvilluar aktivitetet përmbyllëse të pozicioneve të mbetura të kontratës.

Përgaditja e paramasave dhe parallogarive sipas kërkesave të Drejtorisë:

Përpilimi i paramasave të ndryshme

Janë kryer procedurat për zotimin e mjeteve të projekteve, të cilat disa kanë qenë aktive e disa kanë filluar inicimi i procedurave.

- Takimet me projektusin për projekte .
- Puna me palë
- Punë tjera në zyre .

-